



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 5343/Prot.
11

Tiranë, më 13/10/2011

URDHËR

Nr. 511 datë 13/10/2011

PËR

“RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA NË FAZËN DYTË TË KONKURRIMIT ME FORMULARIN A2, TË PRANIMEVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2011 – 2012, NËPËRMJET FORMULARIT A3”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33, të ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 423, datë 08.06.2011 “Për kuotat e pranimit në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2011-2012 si dhe tarifatat e shkollimit”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)” si edhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e Larta Publike”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kuotat e porealizuara, pas mbylljes së fazës përfundimtare të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë për vitin akademik 2011-2012 (raundi i parë i konkurrimit me Formularin A2), të shpërndahen, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur.
2. Plotësimin e formularit A3 nga maturantët/kandidatë të cilët :
 - a) Nuk kanë arritur të përfshihen në listat e fituesve të fazës së parë dhe të dytë të konkurrimit me formularin A2, dhe për rrjedhojë nuk janë regjistruar në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në Institucionet publike të Arsimit të Lartë për vitin akademik 2011-2012;

- b) Janë shpallur fitues në listën paraprake ose përfundimtare të garës me formularin A2 dhe nuk janë të regjistruar në Institucionet publike të Arsimit të Lartë për vitin akademik 2011-2012.
 - c) Rezultuan mbetës në sesionin e parë të provimeve të Maturës Shtetërore (Qershor 2011) dhe arritën rezultate kaluese në provimet e vjeshtës (sesioni i dytë).
 - d) Janë regjistruar në sesionin e dytë të Maturës Shtetërore 2011 nëpërmjet plotësimit të formularit A1Z dhe rezultojnë kalues në të katër provimet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), DAR/ZA-të dhe Institucionet Publike të Arsimit të Lartë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

MYQEREM TAJAJ

MINISTËR



TABELA NR.1:
LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KUOTAVE PËRKATËSE TË FORMULARIT A3

Nr.	UNIVERSITETI	ID_DEGA	EMËRTIMI I DEGËS	Kuota formulari A3
1	UT	001	Histori	5
2	UT	002	Gjeografi	5
3	UT	003	Gjuhë - Letërsi	5
4	UT	005	Biologji	5
5	UT	008	Fizikë	15
6	UT	009	Informatikë	10
7	UT	010	Kimi	5
8	UT	011	Kimi Ushqimore	5
9	UT	012	Kimi Industriale	5
10	UT	013	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	10
11	UT	014	Teknologji Informacioni dhe komunikimi	10
12	UT	015	Gjuhë Angleze	10
13	UT	016	Gjuhë Frënge	10
14	UT	017	Gjuhë Gjermane	10
15	UT	018	Gjuhë Italiane	10
16	UT	019	Gjuhë Greke	10
17	UT	020	Gjuhë Turke	5
18	UT	021	Gjuhë Ruse	15
19	UT	022	Gjuhë Spanjolle	10
20	UT	024	Gjuhë Angleze (Filiali Sarandë)	15
21	UT	027	Filozofi	8
22	UT	035	Administrim - Biznes (Filiali Kukës)	20
23	UT	036	Administrim - Biznes (Filiali Sarandë)	30
24	UT	047	Infermieri e Përgjithshme (Filiali Kukës)	25
25	UT	048	Infermieri e Përgjithshme (Filiali Sarandë)	25
26	UBT	050	Menaxhim Agrobiznesi	15
27	UBT	051	Menaxhim Agrobiznesi (Filiali Lushnjë)	35
28	UBT	052	Ekonomi dhe Politikë Agrare	15
29	UBT	054	Financë – Kontabilitet (Filiali Lushnjë)	20
30	UBT	055	Menaxhim i Turizmit Rural	20
31	UBT	056	Mbrojtje Bimësh	10
32	UBT	057	Hortikulturë	15
33	UBT	058	Hortikulturë (Filiali Lushnjë)	30
34	UBT	059	Prodhim Bimor	25
35	UBT	060	Zootekni dhe Biznes Blegtoral	20
36	UBT	061	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	20
37	UBT	062	Agromjedis dhe Ekologji	10

